

Hyundai Bluelink Europe

Kushtet e përdorimit

Në fuqi nga data 24 nëntor 2023.

Lista e ndryshimeve

- 3.1.3. Është shtuar telekomanda e dritares
- 3.1.4. Janë shtuar boria dhe drita në distancë
- 3.1.5. Është shtuar drita në distancë
- 3.1.12. Është shtuar kondicionimi i baterisë në distancë
- 3.1.13. Është shtuar koha e nisjes
- 3.1.14. Është shtuar rryma e karikimit
- 3.9. Është përditësuar përshkrimi për Hyundai Digital Key
- 4.1.7. Ofertat në afërsi dhe kërkimi i promovuar janë shtuar në kapitull.

Nëse nuk i pranoni ndryshimet në Kushtet e përdorimit, ju lutemi çaktivizojeni shërbimin e Bluelink-ut në sistemin e info-argëtimit përpara datës së hyrjes në fuqi.

1. Hyrje

- 1.1. Për të përdorur shërbimet tona të Hyundai Bluelink Europe ("Bluelink" ose "Shërbimet"), ju lutemi lexoni kushtet e mëposhtme të Hyundai Bluelink Europe ("Kushtet" ose "Kushtet e përdorimit").
Këto Kushte do të zbatohen sa herë që përdorni Shërbimet brenda aplikacionit Bluelink dhe brenda sistemit të info-argëtimit të automjetit.
Versionin më të fundit të këtyre Kushteve mund ta gjeni sa herë që dëshironi në menynë e aplikacionit Bluelink dhe në menynë e sistemit të info-argëtimit (kjo është njësia kryesore e automjetit tuaj).
- 1.2. Ne jemi Hyundai Srbija d.o.o. Beograd. Adresa jonë e regjistruar është: Milutina Milankovića 7V, 11070 Novi Beograd, Srbija. Jemi partneri juaj kontraktual në lidhje me ofrimin e Shërbimeve.
- 1.3. Nëse keni pyetje, na telefononi në numrin +381 011 2252 301 ose na kontaktoni me email në adresën bluelink@hyundai-europe.com.

2. Përdorimi i shërbimeve

- 2.1. Kushtet paraprake të përgjithshme
 - 2.1.1. Për t'i pranuar këto Kushte, duhet të jeni mbi 18 vjeç.
 - 2.1.2. Shërbimet mund t'i përdorni vetëm me automjetet Hyundai të cilat janë të pajisura me harduerin specifik për Bluelink-un, në veçanti një modem me kartë SIM të instaluar paraprakisht dhe një antenë specifike.
 - 2.1.3. Kontrata jonë për ofrimin e Shërbimeve bazuar në këto Kushte duhet të dallohet nga kontrata juaj për blerjen (ose dhënien me qira) të automjetit tuaj Hyundai. Të dyja janë kontrata juridikisht të ndara, të cilat në parim nuk prekin njëra-tjetrën.
 - 2.1.4. Shërbimet janë të lidhura me automjetin tuaj specifik dhe për këtë arsye nuk mund të merren ose të transferohen në një automjet tjetër.

- 2.1.5. Mund t'i çaktivizoni dhe riaktivizoni Shërbimet në çdo kohë nëpërmjet sistemit tuaj të info-argëtimit.
- 2.1.6. Përdorimi i aplikacionit Hyundai Bluelink Europe kërkon pajisje celulare dhe version sistemi operativ të pajtueshëm. Versionet minimale të kërkuara të sistemeve operative janë iOS 10 dhe Android 6.0. Pajisjet e mbështetura zyrtarisht janë iPhone 11 (e lart), Samsung Galaxy S21, S22, S23, S23+, S30 Plus, A50, A54, Z Flip 3, Note 10, Google Pixel 6 Pro, 7 Pro, Huawei P40, Mate P40 Pro, Xiaomi Mi 10 dhe 11, Oppo Find X3 Neo.
- 2.1.7. Ju mund t'i përdorni shërbimet tona të aplikacionit në distancë vetëm nëse aplikacioni merr informacion të drejtpërdrejtë nga automjeti.
Kjo është e mundur vetëm nëse motorinoja e automjetit nuk është fikur për më shumë se katërmëdhjetë ditë për automjetet ccNC (Connected Car Navigation Cockpit) (e instaluar në KONA-n e re dhe modelet më të reja) ose shtatë ditë për automjetet Gen5W (të gjitha modelet e tjera).
- 2.1.8. Jo të gjitha Shërbimet mund të jenë të disponueshme për t'u përdorur me automjetin tuaj specifik – kjo mund të varet nga modeli i automjetit tuaj Hyundai, si dhe nga versioni i softuerit të aplikacionit dhe i sistemit të info-argëtimit.
- 2.1.9. Ne nuk do t'ju tarifojmë për përdorimin nga ana juaj të Shërbimeve gjatë afatit të kontratës sonë (shihni paragrafin 10 më poshtë se kur përfundon kontrata jonë e bazuar në këto Kushte).
- 2.2. Aplikacioni Bluelink
- 2.2.1. Për t'i përdorur Shërbimet, veproni si më poshtë:
- a) Aktivizoni Bluelink-un në automjetin tuaj;
 - b) Shkarkoni aplikacionin **“Hyundai Bluelink Europe”** në Google Play Store ose Apple App Store;
 - c) Identifikohuni në llogarinë tuaj të Hyundai-t;
 - d) Lejojeni Bluelink-un që të ketë akses në të dhënat tuaja personale nga llogaria juaj e Hyundai-t (numrin e telefonit, profilin e përdoruesit, adresën e emailit);
 - e) Futni numrin e telefonit dhe verifikojeni numrin me një kod verifikimi 6-shifror, të cilin do t'ju dërgojmë në numrin e telefonit me SMS;
 - f) Krijoni një PIN 4-shifror për shërbimin tuaj Bluelink;
 - g) Shtoni një automjet Hyundai;
 - h) Pranoni Kushtet e përdorimit të Bluelinkut;
 - i) Lexoni Njoftimin e privatësisë dhe
 - j) Në sistemin tuaj të info-argëtimit, zgjidhni [Bluelink] - [Cilësimet e Bluelink-ut] - [Informacioni i modemit] dhe skanoni kodin QR me telefonin celular. Përndryshe, mund ta vendosni edhe manualisht numrin e identifikimit të automjetit (VIN). Verifikojeni VIN-in duke futur një kod aktivizimi, të cilin do ta dërgojmë në sistemin e info-argëtimit të automjetit.
- 2.2.2. Kontrata mes jush dhe nesh në lidhje me Shërbimet lidhet kur ju jepet akses në Shërbimet ose në aplikacion pas aktivizimit të suksesshëm dhe shtimit të automjetit ose pas aktivizimit të Shërbimeve në menynë e sistemit të info-argëtimit (njësia kryesore e automjetit tuaj).

Disa shërbime disponohen vetëm në Aplikacion (shihni paragrafin 3 më poshtë). Në procesin e abonimit ju ofrohen opsionet e cilësimeve me të cilat mund të korrighoni çdo gabim në regjistrim. Kontrata lidhet në gjuhën shqipe.

Do t'ju japim këto Kushte me email pasi ta keni shtuar me sukses automjetin në aplikacion. Versioni më i fundit i këtyre Kushteve do të jetë gjithashtu i disponueshëm për ju në çdo kohë brenda aplikacionit (shikoni në menynë e aplikacionit "Më shumë"->"Tekstet ligjore") dhe në menynë e sistemit të info-argëtimit (shikoni në njësine kryesore të automjetit "Cilësimet"->"Bluelink" ->"Kushtet e përdorimit").

2.2.3. Nëse nuk keni ende një llogari Hyundai, ju lutemi krijoni një llogari të re duke vepruar si më poshtë:

- a) Hapni aplikacionin Bluelink dhe klikoni te "Krijo llogari".
- b) Shkruani emailin tuaj, emrin, mbiemrin, vendin e banimit dhe fjalëkalimin e dëshiruar.
- c) Pranoni Kushtet e përdorimit që zbatohen për llogarinë Hyundai.
- d) Zgjidhni "Regjistrohu"
- e) Verifikoni adresën e emailit duke futur një kod verifikimi 4-shifror që ju është dërguar në emailin tuaj.

2.2.4. Nëse e keni harruar adresën e emailit ose fjalëkalimin për t'u identifikuar në llogarinë tuaj Hyundai, atëherë mund të klikoni te lidhja "Harruat fjalëkalimin?" në aplikacionin Bluelink.

3. **Lista e shërbimeve të Bluelink-ut: Aplikacioni**

3.1. Shërbimet në distancë

3.1.1. **Njoftimet shtytëse**

Pasi të aktivizohen, njoftimet shtytëse të Bluelink-ut do t'ju ofrojnë informacionin e mëposhtëm. Specifikimet mund të variojnë sipas vendit ose modelit të automjetit:

- Alarmi i vjedhjes
- Dera e hapur / bagazhi i hapur / kofanoja e hapur / kapaku i karikimit i hapur / dritarja e hapur
- Alarmi i shkarkimit të baterisë me tension të lartë
- Sinjalizimi i ndenjës së pasme / sinjalizimi i dritave të bllokazhit / sinjalizimi i dritave anësore / sinjalizimi i motorit në gjendje pune bosh
- Statusi i kontrollit të klimës / statusi i karikimit / dera e kyçur dhe e shkyçur / statusi i përditësimit të softuerit

3.1.2. **Kyçja dhe shkyçja në distancë**

Harruat të kyçnit makinën?

Mos u shqetësoni: Bluelink-u do t'ju njoftojë duke ju dërguar një njoftim shtytës në smartfon.

Më pas, pasi të keni futur kodin PIN, mund ta kyçni ose ta shkyçni automjetin tuaj kudo ku jeni nëpër botë duke përdorur një buton në aplikacionin Bluelink.

3.1.3. Funkcioni i kontrollit të dritareve në distancë ju lejon të hapni dhe mbyllni nga distanca dritaret e automjetit.

3.1.4. **Boria dhe drita në distancë (vetëm disa modele)**

Funksioni i borisë dhe dritës në distancë ju lejon të aktivizoni nga distanca si fenerët ashtu edhe tingullin e borisë së automjetit tuaj për rreth 30 sekonda. Boria mund të ndalet më herët nëse hapni dhe mbyllni derën me çelësin inteligjent.

3.1.5. **Drita në distancë (vetëm disa modele)**

Funksioni i dritës në distancë ju lejon të ndizni nga distanca fenerin e automjetit tuaj për rreth 30 sekonda.

3.1.6. **Karikimi në distancë (vetëm për modelet EV dhe PHEV)**

Karikimi në distancë ju lejon të filloni ose të ndaloni në distancë karikimin.

Për të përdorur karikimin në distancë, thjesht aktivizoni "Auto-charge" brenda Hyundai-t EV ose PHEV.

Sesionet e karikimit mund të ndërpriten në distancë duke përdorur aplikacionin Bluelink.

Kur përdorni stacione karikimi, sesionet duhet të ndërpriten direkt në stacionin e karikimit.

3.1.7. **Karikimi i planifikuar (vetëm për modelet EV dhe PHEV)**

Ky funksion komod ju lejon të konfiguroni një orar karikimi të përshtatur me nevojat tuaja.

Për më tepër, mund të vendosni temperaturën e dëshiruar para se të filloni udhëtimin tuaj të ardhshëm.

3.1.8. **EV POI (vetëm për modelet EV dhe PHEV)**

Kjo veçori ju ndihmon të gjeni stacionet më të afërta dhe më të mira të karikimit për EV-të sipas kërkesave tuaja (si p.sh. lloji i karikimit) dhe preferencave tuaja (nëpërmjet një opsioni filtrimi).

3.1.9. **Kontrolli i klimës në distancë (vetëm EV)**

Kjo veçori specifike për EV-të ju lejon ta kondiciononi paraprakisht makinën sa herë që të dëshironi: thjesht vendosni temperaturën e dëshiruar dhe filloni kontrollin e klimës në distancë.

Për komoditetin tuaj, mund të aktivizoni edhe ngrohjen e xhamit të pasmë dhe të timonit.

3.1.10. **Hapja/mbyllja në distancë e kapakut të karikimit (vetëm disa EV)**

Kjo veçori ju lejon ta hapni dhe ta mbyllni në distancë kapakun e karikimit të automjetit.

3.1.11. **Kontrolli në distancë i dritave të bllokazhit / dritave anësore (jo të gjitha automjetet)**

Kur automjeti mbetet me dritat e bllokazhit dhe/ose dritat anësore të ndezura, aplikacioni Bluelink do t'ju informojë nëpërmjet një njoftimi.

Mund t'i fikni dritat në distancë duke përdorur aplikacionin.

3.1.12. **Kjo veçori ju ndihmon të optimizoni temperaturën e baterisë në mënyrë që të përmirësoni performancën e karikimit të automjetit.**

3.1.13. **Kjo veçori ju lejon të aktivizoni klimën e planifikuar. Vendosni temperaturën e synuar dhe opsionin e shkrirjes për dy orare të ndryshme nisjeje.**

- 3.1.14. Në menynë e rrymës së karikimit, mund ta rregulloni rrymën e dhënë nga karikuesi i ngadaltë në 60%, 90% ose 100%.
- 3.1.15. **Gjej makinën time**
Keni harruar ku keni parkuar? Thjesht hapni aplikacionin Bluelink dhe harta do t'ju orientojë atje.
- 3.1.16. **Dërgo te makina**
Aplikacioni Bluelink ju lejon të kërkonti për destinacione ndërsa jeni ulur në divan. Bluelink-u më pas sinkronizohet me sistemin tuaj të navigimit duke e ngarkuar itinerarin në mënyrë që të jetë gati kur të jeni gati edhe ju. Thjesht hyni në makinë dhe shtypni "Go".
- 3.1.17. **POI-ja për makinën time**
Funksioni "POI-ja për makinën time" sinkronizon POI-të e ruajtura (pikat e interesit), si "Shtëpia" ose "Adresa e punës", midis sistemit të info-argëtimit dhe aplikacionit Bluelink.
- 3.1.18. **"Last mile navigation"**
Mund t'ju duhet ta parkoni makinën diku përpara se të arrini në destinacionin aktual. Nëse jeni nga 200 m deri në 2 km larg destinacionit, mund ta transferoni navigimin nga makina, tek aplikacioni Bluelink.
Me realitetin e shtuar ose Google Maps, smartfoni do t'ju drejtojë më pas pikërisht atje ku dëshironi të shkoni.
- 3.1.19. **"First Mile Navigation"**
"First Mile Navigation" ju udhëzon drejt automjetit nëpërmjet realitetit të shtuar ose Google Maps. Dërgojeni destinacionin në automjet duke përdorur aplikacionin Bluelink.
Nëse jeni nga 200 m deri në 2 km larg automjetit, smartfoni do t'ju drejtojë te vendndodhja e automjetit.
- 3.1.20. **Modaliteti i parkimit "valet"**
Modaliteti i parkimit "valet" mbron informacionet e tua private të sistemit të info-argëtimit kur ia jepni çelësat e makinës një personi tjetër. Pasi të aktivizohet shërbimi në sistemin e info-argëtimit, shoferi mund të shikojë vetëm ekranin e modalitetit "valet". Kamera e pasme dhe e-Call do të vazhdojnë të funksionojnë.
Modaliteti i parkimit "valet" ofron edhe informacionet e mëposhtme në aplikacionin Bluelink:
– Fillimi dhe përfundimi i udhëtimit
– Distanca e udhëtimit
– Koha e udhëtimit
– Shpejtësia maksimale
Mund ta çaktivizoni modalitetin e parkimit "valet" duke përdorur fjalëkalimin tuaj në sistemin e info-argëtimit ose në aplikacionin Bluelink.

3.2. Informacione për statusin e automjetit nëpërmjet Bluelink-ut

3.2.1. **Raporti i automjetit**

Raporti i automjetit ofron informacione në lidhje me përdorimin e automjetit tuaj Hyundai. Gjithashtu mund të kontrolloni gjendjen e njësive më të rëndësishme të kontrollit, si jastëkët e ajrit, frenat, presionin e gomave etj.

3.2.2. **Përditësimi i statusit**

Përditësimi i statusit ju informon për statusin e automjetit. Në varësi të automjetit tuaj, mund të shihni informacione për sa më poshtë:

- Distanca deri në zbrazjen e serbatorit
- Niveli i karburantit
- Motori i ndezur/fikur
- Statusi i kyçjes së derës
- Statusi i kontrollit të klimës
- Portobagazhi i hapur/mbyllur
- Kofanoja e hapur/mbyllur
- Dritarja e hapur/mbyllur
- Tavani i hapur/mbyllur
- Gjendja e presionit të gomave
- Gjendja e baterisë me tension të lartë (vetëm për modelet EV dhe PHEV)
- Karikimi i planifikuar aktiv/joaktiv
- Kontrolli i planifikuar i klimës aktiv/joaktiv
- Kapaku i karikimit i hapur/mbyllur (vetëm për disa automjete elektrike)
- Statusi i ngrohjes së timonit (vetëm për disa automjete elektrike)
- Shkrirja ndezur/fikur (vetëm automjetet elektrike)
- Ngrohja e xhamit të pasmë ndezur/fikur (vetëm për disa automjete elektrike)
- Ngrohja e pasqyrës anësore (vetëm për disa automjete elektrike)
- Gjendja e llambave
- Fuqia aktuale e karikimit (gjatë karikimit, vetëm për disa automjete elektrike)

3.2.3. **Udhëtimet e mia**

Funksioni "Udhëtimet e mia" ofron informacione rreth përdorimit të automjetit tuaj në ditë ose në muaj. Për çdo udhëtim, mund të kontrolloni kohën e kaluar, kilometrazhin, shpejtësinë mesatare dhe shpejtësinë maksimale. Informacioni te "Udhëtimet e mia" është i disponueshëm për një periudhë maksimale prej 90 ditësh.

3.2.4. **Konsumi i energjisë (vetëm për modelet EV)**

Monitoruesi i konsumit të energjisë ofron një përmbledhje të konsumit ditor dhe mujor të energjisë të automjetit tuaj elektrik. Ju mund të kontrolloni konsumin total dhe mesatar të energjisë, distancën e udhëtimit dhe informacionet për rikuperimin e energjisë.

3.3. Ndarja e makinës me të tjerët

3.3.1. **Ndaje makinën me të tjerë**

Ju mund t'i ndani Shërbimet me një ose më shumë përdorues të tjerë nëpërmjet funksionit "Ndaje makinën me të tjerë" në aplikacionin Bluelink.

Nëse përdorni funksionin "Ndaje makinën me të tjerë", do të ndani Shërbimet dhe të dhënat për automjetin tuaj Hyundai të regjistruar në aplikacionin Bluelink.

Për t'i përdorur Shërbimet e ndara, përdoruesi tjetër duhet të ndjekë hapat e përshkruar në paragrafin 2.2.1 më sipër.

Mund ta ndaloni në çdo kohë ndarjen e Shërbimeve duke hequr çdo përdorues tjetër të "Cilësimit e makinës së ndarë me të tjerë". Më pas ne do t'i fshijmë të gjitha të dhënat e ndara në aplikacionin Bluelink të përdoruesit tjetër.

3.3.2. **Kërkesë për ta ndarë makinën me të tjerë**

Ju mund t'u kërkonti përdoruesve të tjerë të Bluelink-ut që t'i ndajnë Shërbimet dhe të dhënat në lidhje me automjetet e tyre Hyundai në aplikacionin Bluelink përmes funksionit "Kërkesë për ta ndarë makinën me të tjerë" në aplikacionin Bluelink.

3.4. Transferimi i profilit të përdoruesit

Ju mund t'i kontrolloni dhe t'i ndryshoni cilësimet e automjetit në aplikacionin Bluelink. Mund të bëni kopje rezervë të informacionit të cilësimeve dhe t'i zbatoni në automjetin tuaj.

3.5. Lista e shërbimeve

Në listën e shërbimeve, mund të çaktivizoni disa shërbime Bluelink. Shërbimet në distancë të bazuara në vendndodhje, informacionet për automjetin, sinjalizimi/siguria dhe veçoritë e përmirësimit të produktit/shërbimit mund të aktivizohen/çaktivizohen më vete.

3.6. Kalendari

Mund të sinkronizoni kalendarin tuaj të Google ose kalendarin e iCloud në aplikacionin Bluelink për të kontrolluar takimet tuaja të ardhshme në ekranin e info-argëtimit.

3.7. Touch ID dhe Face ID (iOS) ose gjurma e gishtit dhe njohja e fytyrës (Android)

Mund t'i përdorni disa funksione të aplikacionit tonë me Touch ID ose Face ID (iOS) ose me gjurmën e gishtit dhe njohjen e fytyrës (Android), në vend të kodit PIN. Mund ta çaktivizoni në çdo kohë përdorimin e Touch ID ose Face ID (iOS) ose të gjurmës së gishtit dhe njohjes së fytyrës (Android) në aplikacionin tonë.

3.8. Shërbimet e sinjalizimit

3.8.1. **Sinjalizimi "valet"**

Sinjalizimi "valet" ju njofton nëse automjeti po udhëton përtej kufirit të distancës, kufirit të shpejtësisë (opsionale) dhe kufirit të kohës bosh të motorit (opsionale) që keni paracaktuar në aplikacionin Bluelink.

Kufiri i distancës llogaritet duke filluar nga vendi ku është aktivizuar sinjalizimi në automjetin tuaj ose në aplikacionin Bluelink.

3.8.2. **Sinjalizimi i rrethimit gjeografik**

Mund të vendosni kufij për zonat e lejuara dhe të kufizuara të automjetit tuaj në aplikacionin Bluelink.

Kur aktivizoni sinjalizimin e rrethimit gjeografik në automjetin tuaj, do të njoftoheni nëse automjeti del nga një zonë e lejuar ose hyn në një zonë të kufizuar.

3.8.3. **Sinjalizimi i shpejtësisë**

Ky funksion ju lejon të paracaktoni një kufi shpejtësie për automjetin në aplikacionin Bluelink. Do të njoftoheni nëse automjeti e tejkalon këtë kufi shpejtësie.

3.8.4. **Sinjalizimi i intervaleve kohore**

Mund të caktoni intervale kohore në aplikacionin Bluelink kur automjeti është në lëvizje. Do të njoftoheni nëse automjeti juaj përdoret jashtë këtyre intervaleve kohore.

3.8.5. **Sinjalizimi i kohës bosh të motorit**

Mund të caktoni sinjalizimin e kohës bosh të motorit në aplikacionin Bluelink për t'ju njoftuar nëse motori i automjetit është në punë, kur automjeti nuk po lëviz jashtë kufirit të kohës bosh që keni futur në aplikacionin Bluelink.

3.9. Hyundai Digital Key (Çelësi dixhital i Hyundai-t)

3.9.1. Hyundai Digital Key është një veçori opsionale e disponueshme për modele të zgjedhura të Hyundai-t dhe mund të zgjidhet vetëm kur blihet automjeti.

3.9.2. Hyundai Digital Key ju lejon ta zhblokoni, ta kyçni dhe ta ndizni automjetin tuaj me smartfonin tuaj ose pajisje të tjera inteligjente pa pasur nevojë të mbani një çelës fizik inteligjent me vete. Ju lutemi, kontrolloni nëse smartfoni juaj është i pajtueshëm dhe nëse e mbështet plotësisht këtë funksion, në faqen tonë të internetit (<https://www.hyundai.com/eu/driving-hyundai/owning-a-hyundai/bluelink-connectivity/digital-key.html>).

3.9.3. Për të aktivizuar këtë funksion, duhet të shkarkohet dhe të konfigurohet aplikacioni Bluelink (shih paragrafin 2.2 më lart për udhëzime se si ta bëni këtë) dhe të aktivizohet Hyundai Digital Key. Për të aktivizuar Hyundai Digital Key, duhet të jeni brenda automjetit me motorin të ndezur dhe marshin në statusin P. Filloni procesin e çiftimit nga aplikacioni Bluelink duke klikuar "Më shumë" -> "Çelësi dixhital i automjetit" -> "Regjistro çelësin dixhital". Procesi i aktivizimit do të kalojë në aplikacionin tuaj të portofolit dhe do t'u nënshtrohet kushteve të tij përkatëse. Pasi të fillojë procesi i regjistrimit nga aplikacioni i portofolit tuaj, vendoseni smartfonin në bllokun e karikimit me valë të automjetit.

3.9.4. Konfigurimi fillestar kërkon dy çelësa inteligjentë fizikë që të jenë me ju brenda automjetit. Duke vepruar kështu, ju konfirmoni se jeni i autorizuar ta shisni automjetin dhe se keni të drejtë ta aktivizoni dhe ta përdorni funksionin e Hyundai Digital Key të automjetit të lidhur, në përputhje me këtë paragraf.

3.9.5. Hyundai Digital Keys mund të aktivizohen në një smartfon/pajisje inteligjente brenda Kushteve të përdorimit, siç përcaktohen në këtë paragraf dhe në paragrafin 11. Çdo Hyundai Digital Key skadon automatikisht kur kontrata me ju bazuar në këto Kushte përdorimi përfundon në përputhje me paragrafin 11.2.

3.9.6. Ju mund t'i ndani Hyundai Digital Keys me disa smartfonë. Ju mund t'i aktivizoni Hyundai Digital Keys edhe në pajisje të tjera inteligjente në varësi të ndërveprimit të tyre. Ju lutemi, gjeni detaje të tjera teknike në faqen tonë të internetit (<https://www.hyundai.com/eu/driving-hyundai/owning-a-hyundai/bluelink-connectivity/digital-key.html>).

Ju mund të ndani dhe të menaxhoni një Hyundai Digital Key përmes aplikacionit të portofolit dhe, edhe në këtë rast zbatohen Kushtet përkatëse të përdorimit. Kur ndani Hyundai Digital Key, ju mund të kufizoni se cilat veçori mund të aksesohen. Ju mund ta revokoni një Hyundai Digital Key të përbashkët ose ta fshini një çelës dixhital të aktivizuar në çdo kohë, përpara se ai të skadojë, nëpërmjet aplikacioneve përkatëse

të portofolit ose nëpërmjet sistemit të info-argëtimit ("Cilësimet" -> "Automjeti" -> "Çelësat dixhitalë" -> "Çelësi i smartfonit" -> "Fshi"). Nëse Hyundai Digital Key fshihet nga përdoruesi me të cilin është ndarë ose është marrë nga pronari kryesor i Hyundai Digital Key, përdoruesi i përbashkët nuk mund të ketë më akses në automjet.

- 3.9.7. Pasi të keni aktivizuar funksionin e Hyundai Digital Key, ju jeni përgjegjës për t'u siguruar që të lejoni vetëm individë të besuar të përdorin Hyundai Digital Keys. Në veçanti, nuk duhet të lejoni që marrësi i një Hyundai Digital Key të drejtojë automjetin nëse nuk ka leje drejtimi të vlefshme dhe/ose nëse marrësi nuk është në gjendje dhe nuk është i autorizuar për të drejtuar automjetet në shtetin përkatës në kohën kur dëshiron të drejtojë makinën.
- 3.9.8. Në rast shitjeje ose të një transferimi tjetër të përhershëm të automjetit të një palë e tretë, ju jeni i detyruar të fshini të gjithë Hyundai Digital Keys aktivë në kohën e duhur, si pjesë e detyrimeve tuaja sipas paragrafit 7.4.
- 3.9.9. SHËNIM: Hyundai Digital Key bazohet në teknologjinë NFC (Komunikimi në fushë të afërt) ose UWB (brezi ultra i gjerë). Nëse pajisja juaj e Hyundai Digital Key është e fikur ose bateria është e shkarkuar plotësisht, do të mund ta përdorni Hyundai Digital Key vetëm për një kohë të kufizuar pas kësaj. Për më shumë udhëzime në lidhje me përdorimin e sigurt të Hyundai Digital Key, ju lutemi konsultohuni me manualin e automjetit.

4. **Lista e shërbimeve të Bluelink-ut: sistemi i info-argëtimit**

4.1. Hyundai Live

Hyundai Live ju lejon të përdorni funksionet e mëposhtme përmes sistemit të info-argëtimit të automjetit:

4.1.1. **Trafiku drejtpërdrejt**

Bluelink-u përdor informacionin e trafikut në kohë reale për t'ju ofruar itineraret më të mira sipas kushteve mbizotëruese. Kjo lejon itinerare më të shpejta dhe kohë më të sakta të mbërritjes.

4.1.2. **Parkimet drejtpërdrejt**

Funksioni "Parkimet drejtpërdrejt" ju ndihmon të gjeni një vend për një parkim më efikas dhe pa stres.

Informacionet për parkimet bëjnë të mundur krahasimin e opsioneve të parkimit në parkimet shumëkatëshe, parkingjet dhe në rrugë.

Funksioni "Parkimet drejtpërdrejt" ofron informacione në lidhje me hapësirat e lira të parkimit duke përdorur një sistem semafori (me ngjyrat jeshile, të verdhë dhe të kuqe), si dhe informacione për çmimet, aty ku është e aplikueshme.

4.1.3. **Pikat e karburantit drejtpërdrejt**

Kjo veçori ju ndihmon të gjeni pikën më të afërt dhe më të lirë të karburantit pranë jush. Funksioni "Pikat e karburantit drejtpërdrejt" ofron informacione drejtpërdrejt mbi çmimin e karburantit, si edhe një tregues të nivelit të çmimit duke përdorur ngjyrat (jeshile, e kuqe).

4.1.4. **POI-të (Pikat e interesit) për EV-të drejtpërdrejt (vetëm për modelet EV dhe**

PHEV)

Funksioni "POI-të për EV-të drejtpërdrejt" ju ndihmon të gjeni stacionin më të afërt dhe më të mirë të karikimit për EV-të sipas kërkesave tuaja (si p.sh. lloji i karikimit).

4.1.5. Moti

Kjo veçori ofron informacione për motin për pesë ditët e ardhshme.

4.1.6. Servisi i Hyundai-t

Kjo veçori ju lejon të gjeni lehtësisht informacionet dhe detajet e kontaktit të distributorit ose të servisit të Hyundai-t më të afërt.

4.1.7. POI-të drejtpërdrejt dhe kërkim me tekst të lirë drejtpërdrejt

Me Bluelink, ne ofrojmë një shërbim shumë të fuqishëm të drejtpërdrejtë në internet POI (pika e interesit) që ju lejon gjithashtu të merrni informacione të mëtejshme (të tilla si oraret e hapjes) dhe oferta të bazuara në vendndodhje për POI të caktuara drejtpërdrejt në ekranin e navigimit të sistemit tuaj të info-argëtimit. Këto POI do të shfaqen si një pineskë e vogël e markës me logon përkatëse të shitësit të zgjedhur të palëve të treta në hartën e navigimit. Do t'ju shfaqet një simbol "%" pranë logos nëse ka një promovim të vazhdueshëm që mund të jetë me interes për ju. Nëse klikoni simbolin, do të hapet një ekran me detaje që përmban informacion shtesë, një ofertë dhe, për shembull, një skonto ose kod QR promocional.

Ju gjithashtu mund të kërkoni për POI të ndryshme duke zgjedhur kategorinë tuaj të dëshiruar të POI (p.sh. stacion karburanti, parkim, pazare/dyqane ushqimore) në sistemin e navigimit. Nëse ka një promocion ose fushatë aktuale për një nga shitësit e përzgjedhur, ajo do të shfaqet në krye të listës dhe do të shihni një simbol "%" që tregon një ofertë. Duke klikuar mbi shitësin përkatës, do të merrni detaje të mëtejshme mbi POI dhe do të aksesoni ofertën si skonto ose kod QR promocional në ekranin e detajeve.

Për më tepër, mund të gjeni një listë të ofertave aktuale përkatëse të bazuara në vendndodhje në të gjitha kategoritë e POI-ve në "Ofertat në afërsi" në menunë "POI në afërsi" të sistemit të navigimit.

Ju gjithashtu mund t'ju dërgohen oferta dhe informacione nga automjeti drejtpërdrejt në aplikacionin tuaj Bluelink si njoftime shtytëse duke klikuar ikonën ose butonin e smartfonit të titulluar "Dërgo në telefon" në ekranin e detajeve. Ju mund të gjeni një listë të të gjitha njoftimeve shtytëse të dërguara nga automjeti juaj në "Më shumë" - "Kutia hyrëse e ofertave".

Për t'ju dërguar oferta interesante dhe me cilësi të lartë, ne përdorim shërbimet e një ofruesi shërbimi palë të tretë që ofron një platformë ku shitësit/partnerët e zgjedhur nga të gjitha kategoritë përkatëse të POI mund të nisin fushatat e tyre përkatëse të marketingut. Shitësi paguan Hyundai-n për çdo përshtypje të pineskës dhe ndërveprim me një nga ofertat e tyre. Nëse nuk dëshironi të shihni këtë lloj marketingu të filialeve, ju lutemi çaktivizoni shërbimin Hyundai Live në aplikacionin tuaj Bluelink dhe nuk do të mund të përdorni asnjë nga shërbimet Hyundai Live.

4.1.8. Sinjalizimet për kamerat/zonat e rrezikut (vetëm nëse lejohet ligjërisht në vendin tuaj)

Ky funksion dërgon sinjalizime në zonat ku aksidentet janë veçanërisht të zakonshme dhe ju paralajmëron për "zonat e rrezikut", kamerat e shpejtësisë dhe semaforët.

4.1.9. **Liga sportive**

Veçoria e ligës sportive ofron rezultatet e ndeshjeve të fundit. Sportet e mbështetura aktualisht janë futbollit, basketbolli, bejsbolli dhe golfi, si dhe kampionati botëror i atletikës, Lojërat Olimpikë dhe Kupa e Botës e FIFA-s.

4.2. Njohja zanore online

Ju mund të përdorni gjuhën e folur për të aksesuar dhe kontrolluar sistemin e info-argëtimit dhe për të hartuar dhe dërguar mesazhe me tekst.

Njohja zanore online funksionon në mjedisin tonë në renë kompjuterike të Bluelink-ut. Kampionet tuaja zanore dhe koordinatat GPS do të përpunohen për të kryer dhe përmirësuar shërbimin e njohjes zanore.

Njohja zanore online aktualisht disponohet në gjuhët e mëposhtme: anglisht, gjermanisht, frëngjisht, italisht, spanjisht dhe holandisht.

Nëse njohja zanore online është e çaktivizuar ose nuk ofrohet, mund të përdorni njohjen zanore jashtë linje. Dallimi është se modaliteti jashtë linje mbështet vetëm komanda specifike. Rezultatet e kërkimit janë nxjerrë nga një databazë e brendshme, e cila mund të jetë më pak e përditësuar. Në modalitetin jashtë linje, ne nuk do t'i përpunojmë kampionet zanore dhe koordinatat GPS për të përmirësuar shërbimin.

4.3. Diagnostikimi i automjetit

Diagnostikimi i automjetit jep informacion rreth kodeve të defekteve aktive (mesazhet e defekteve të automjetit) të disa njësive të kontrollit të automjetit.

4.4. Connected Routing

Connected Routing do të thotë që rruga nga pozicioni juaj aktual në destinacionin tuaj llogaritet nga një server i fuqishëm brenda mjedisit në renë kompjuterike të Bluelink-ut, dhe jo vetëm nga sistemi i info-argëtimit.

Pse është më e mirë kjo? Sepse lejon parashikime më të sakta të trafikut, kohë më të sakta të mbërritjes dhe rillogaritje më të besueshme të itinerarit.

4.5. Profili i përdoruesit të Bluelink-ut

Profili i përdoruesit të Bluelink-ut ju lejon të ruani cilësime të ndryshme të automjetit në renë tuaj kompjuterike të Bluelink-ut dhe t'i zbatoni ato në automjete të ndryshme. Për të konfiguruar profilin tuaj e përdoruesit, ndiqni udhëzimet në sistemin e info-argëtimit dhe lidheni profilin me llogarinë tuaj Hyundai. Mund të konfiguroni dy profile për automjet plus një profil vizitori.

Ju mund ta përdorni këtë veçori ku dy ose më shumë shoferë përdorin të njëjtin automjet, por preferojnë cilësime të ndryshme për zërin, gjuhën ose pamjen e hartës. Këtu është një listë e elementeve të ndryshme që mund të ruhen nën profilin e shoferit/përdoruesit:

- Fotografia e profilit
- Lidhja me telefonin
- Cilësimet e datës dhe orës
- Cilësimet e përgjithshme
- Cilësimet e zërit
- Cilësimet e ekranit
- Cilësimet e njohjes zanore
- Cilësimet e radios
- Cilësimet e automjetit

– Cilësimet e navigimit

Të gjitha këto cilësime mund të eksportohen në një automjet tjetër nëpërmjet Bluelink-ut. Nëse një miku juaj po e përdor automjetin tuaj përkohësisht, mund të përdorni një profil vizitori.

4.6. Qendra e njoftimeve

Qendra e njoftimeve na lejon t'ju dërgojmë informacione për automjetin tuaj. E përdorim këtë shërbim vetëm për informacione të rëndësishme. Informacioni do të shfaqet si një dritare kërcyese në sistemin e info-argëtimit. Mund ta çaktivizoni marrjen e llojeve të caktuara të informacioneve të cilësimet ose kur merrni një dritare kërcyese.

4.7. Kalendari

Bluelink-u ju lejon ta sinkronizoni kalendarin tuaj të Google ose Apple me funksionin e integruar të kalendarit në sistemin e info-argëtimit.

4.8. Veçoria e pëlqimeve

Gjatë luajtjes së muzikës nëpërmjet USB-së, Bluetooth-it ose radios, mund të klikoni butonin "gishti lart" ose "gishti poshtë" për të shënuar preferencën tuaj. Këngët e pëlqyera do të shtohen në listën e luajtjes (vetëm për USB-në).

4.9. SoundHound

SoundHound-i ju lejon, për shembull, të identifikoni këngët që po dëgjoni në radio, dhe merr informacione të tilla si titulli, interpretuesi dhe kopertina e albumit, të cilat më pas shfaqen drejtpërdrejt në sistemin tuaj të info-argëtimit. Ju mund të keni akses në informacionin përkatës në historikun tuaj të kërkimit të SoundHound-it ["Radioja" -> "Menyja"-> Historiku i SoundHound-it"] dhe ta fshini atë në çdo kohë.

4.10. Transmetimi muzikor

Me veçorinë e transmetimit muzikor, mund të transmetoni muzikë në automjetin tuaj drejtpërdrejt nga disa shërbime të transmetimit muzikor nëpërmjet sistemit të info-argëtimit. Për ta përdorur këtë veçori, kërkohet një abonim i vlefshëm për shërbimin përkatës të transmetimit muzikor. Nuk do të ketë kosto shtesë për sa kohë jeni abonuar në Bluelink.

Për ta aktivizuar këtë veçori, shkoni te menyja "Media" e sistemit tuaj të info-argëtimit dhe zgjidhni shërbimin e transmetimit muzikor. Skanoni kodin QR me telefonin tuaj për të lidhur llogarinë tuaj për shërbimin e transmetimit muzikor. Do të drejtoheni në faqen e identifikimit të shërbimit përkatës nëpërmjet aplikacionit Bluelink. Pas identifikimit të suksesshëm, klikoni butonin "Lidh dhe vazhdo" në ekranin e sistemit të info-argëtimit të automjetit. Vini re se mund ta lidhni llogarinë tuaj vetëm nëse e keni shtuar automjetin tuaj në aplikacionin Bluelink dhe e keni lidhur aplikacionin me profilin e drejtuesit të automjetit.

Vini re se transmetimi muzikor është i disponueshëm vetëm për modele të caktuara Hyundai. Detaje të mëtejshme mund të gjeni në uebsajtin tonë

(<https://www.hyundai.com/eu/driving-hyundai/owning-a-hyundai/bluelink-connectivity/amazon-music.html>).

5. **Përditësimi OTA (Over-the-Air)**

Për sa i përket modeleve të caktuara të automjeteve, siç komunikohet nga Hyundai, Bluelink-u ofron përditësime të softuerit me valë ("over-the-air") ("Përditësimet OTA") për sistemin e automjetit, si dhe për hartën dhe sistemin e info-argëtimit.

Sistemi i info-argëtimit do të kontrollojë rregullisht nëse janë të disponueshme versione të reja të softuerit dhe do të shkarkojë automatikisht çdo përditësim të disponueshëm të softuerit në automjetin tuaj dhe do të përgatisë instalimin përkatës nëse keni dhënë pëlqimin për të. Ju mund ta përdorni ende sistemin e info-argëtimit gjatë procesit të shkarkimit dhe të përgatitjes.

Përpara se përditësimi i softuerit të instalohet dhe të finalizohet, sistemi do t'ju pyesë nëse dëshironi ta përfundoni përditësimin e softuerit tani ose më vonë. Me çdo përditësim, do t'ju ofrohen detaje të përmbajtjes së tij, si dhe informacione të mëtejshme mbi procesin e përditësimit.

Mund ta çaktivizoni këtë veçori duke çaktivizuar çelësin në aplikacionin Bluelink ("Më shumë" -> "Lista e shërbimeve"). Përndryshe, mund ta çaktivizoni lidhjen Bluelink nëpërmjet sistemit të info-argëtimit në automjetin tuaj ("Cilësimet" -> "Bluelink-u" -> "Çaktivizo Bluelink-un").

Në këtë rast ose nëse për ndonjë arsye nuk instaloni një përditësim OTA, përditësimet e softuerit mund të kryhen si zakonisht (manualisht nëpërmjet USB-së ose kartës SD, si dhe në një servis Hyundai).

Vini re se për disa përditësime të softuerit të kryera në një servis me kërkesën tuaj, mund të ketë kosto shtesë. Kontaktoni shitësin tuaj paraprakisht për detaje. Nuk do të aplikohet asnjë tarifë në rastin e përditësimeve që lidhen me fushatat e shërbimit të detyrueshëm.

Për më tepër, ne rezervojmë të drejtën për të kryer përditësime të caktuara të softuerit ekskluzivisht në serviset tona të caktuara të distributorëve. Nuk jeni i detyruar t'i shkarkoni ose t'i instaloni përditësimet OTA; megjithatë, nëse nuk e bëni këtë, automjeti juaj ose shërbimet e ofruara (si sistemet e lidhura me sigurinë, sistemi i info-argëtimit, Bluelink-u) mund të mos funksionojnë siç duhet ose mund të mos funksionojnë fare.

5.1. Përditësimi OTA i sistemit të automjetit

Përditësimet OTA mund të lidhen me sistemin e automjetit dhe mund të ofrohen për arsye të ndryshme dhe për qëllime të ndryshme, veçanërisht për të korrigjuar një defekt brenda periudhës përkatëse të garancisë ose brenda fushës së garancisë së prodhuesit ose për arsye të tjera të lidhura me sigurinë.

Nëse ofrohet një përditësim i softuerit përmes shërbimit të përditësimit OTA të Bluelink-ut, do të mbeten të paprekura dispozitat ligjore ose marrëveshje të tjera që përmbajnë dispozita mbizotëruese në lidhje me vetë përditësimin e softuerit.

Lexoni me kujdes çdo njoftim përditësimi dhe ndiqni udhëzimet e shfaqura. Ju nuk mund ta përdorni automjetin gjatë procesit të instalimit.

5.2. Përditësimi OTA i hartave dhe i info-argëtimit

Bluelink-u mund të ofrojë gjithashtu përditësime OTA për hartat dhe sistemin e info-argëtimit të automjetit tuaj gjatë afatit të kontratës sonë (shihni paragrafin 10 më poshtë se kur përfundon kontrata jonë e bazuar në këto Kushte).

Përditësimet OTA për sistemin e info-argëtimit mund të përfshijnë përditësime të nevojshme për mirëmbajtjen e Shërbimeve të Bluelink-ut në përputhje me këto Kushte (p.sh. për të ruajtur funksionalitetin, përputhshmërinë ose sigurinë). Do t'ju ofrojmë përditësime të tilla gjatë kohëzgjatjes së kësaj kontrate.

Informacione të mëtejshme mbi procesin e përditësimit dhe detajet e përmbajtjes së çdo përditësimi të softuerit do të jepen me çdo njoftim përditësimi. Ju nuk mund ta përdorni sistemin e info-argëtimit gjatë procesit të instalimit.

6. **Të drejtat e pronësisë intelektuale**

- 6.1. Përmbajtja e Shërbimeve mbrohet nga ligji në fuqi për të drejtën e autorit ose nga ligjet e tjera të pronësisë intelektuale me të gjitha të drejtat e rezervuara. Të gjitha të drejtat për Shërbimet, në veçanti softueri bazë, përmbajtja dhe organizimi, janë në pronësi ose të licencuara për Hyundai Motor Group. ("Hyundai Motor Group" i referohet Hyundai Motor Company dhe kompanive të lidhura me të.)
- 6.2. Asgjë në këto Kushte përdorimi nuk duhet të interpretohet si dhënie e një licence ose e së drejtës:
 - 6.2.1. për të përdorur çdo imazh, markë tregtare, markë shërbimi ose logo, të cilat të gjitha janë pronë e Hyundai Motor Group. Hyundai Motor Group rezervon të gjitha të drejtat në lidhje me informacionet ose materialet e tij të pronësisë në lidhje me Shërbimet dhe do t'i zbatojë këto të drejta në masën e plotë të ligjit në fuqi për të drejtat e autorit dhe markat tregtare;
 - 6.2.2. për të marrë me qira, dhënë me qira, nën-licencuar, dhënë hua, ofruar ose ndryshe për të vënë në dispozicion të ndokujt Hyundai Bluelink-un ose Shërbimet në çfarëdo forme, tërësisht ose pjesërisht, pa pëlqimin paraprak me shkrim nga ne;
 - 6.2.3. për të kopjuar Hyundai Bluelink-un ose Shërbimet, përveçse si pjesë e përdorimit normal të Hyundai Bluelink-ut ose kur është e nevojshme për të bërë kopje rezervë apo për sigurinë operative;
 - 6.2.4. për të përkthyer, bashkuar, përshtatur, ndryshuar ose modifikuar Hyundai Bluelink-un ose Shërbimet tërësisht ose pjesërisht; as për të lejuar që Hyundai Bluelink-u ose Shërbimet ose ndonjë pjesë e tyre të kombinohen ose të përfshihen në ndonjë program tjetër, përveç rasteve kur është e nevojshme për përdorimin e Hyundai Bluelink-ut dhe të Shërbimeve në pajisjet, siç lejohet në këto Kushte përdorimi;
 - 6.2.5. për të çmontuar, për të dekompileuar, për të kryer zbërthim të kundërt ose për të krijuar vepra derivate bazuar në Hyundai Bluelink-un ose Shërbimet tërësisht ose pjesërisht; as përpjekja për të kryer veprime të tilla, përveç rasteve kur veprime të tilla nuk mund të ndalohen nga ligjet në fuqi ("Objektivi i lejuar") dhe me kusht që informacionet e marra nga ju gjatë aktiviteteve të tilla:
 - 6.2.5.1. të mos i zbulohen ose të mos i komunikohen pa pëlqimin tonë paraprak me shkrim ndonjë pale të tretë të cilës nuk është e nevojshme t'i zbulohen ose t'i komunikohen për të arritur Objektivin e lejuar;
 - 6.2.5.2. të mos përdoren për të krijuar ndonjë softuer që në thelb të jetë i ngjashëm në shprehjen e tij me Hyundai Bluelink-un;
 - 6.2.5.3. të mbahen të sigurt dhe
 - 6.2.5.4. të përdoren vetëm për Objektivin e lejuar.

7. **Detyrimet e përdoruesit**

7.1. Ju mund t'i përdorni Shërbimet vetëm nëse i respektoni këto Kushte.

7.2. Në veçanti, sigurohuni që:

- a) të respektoni ligjet dhe rregulloret në fuqi dhe të respektoni të drejtat e palëve të treta kur përdorni Shërbimet;
- b) të mos i përdorni Shërbimet për qëllime të paligjshme ose të mos lehtësoni përdorimin e paligjshëm të Shërbimeve nga palët e treta;
- c) të mos e modifikoni automjetin tuaj (duke përfshirë modifikimet e harduerit dhe të softuerit, si dhe përdorimin e softuerëve të palëve të treta) në mënyrë të tillë që të preket funksionaliteti i Shërbimeve;
- d) të mos i prishni me dashje Shërbimet në asnjë mënyrë;
- e) të mos e përdorni kartën SIM të integruar në sistemin e info-argëtimit të automjetit që përdoret për ofrimin e Shërbimeve:
 - i) për transmetimin e zërit (përfshirë VOIP-në);
 - ii) për të aksesuar një destinacion të adresueshëm publikisht (d.m.th. një adresë IP publike) duke përfshirë përdorimin e një serveri ndërmjetës, portëkalimi ose rrugëzimi;
 - iii) në një mënyrë që tenton të depërtojë në masat e sigurisë, pavarësisht nëse ndërhyrja rezulton në dëmtim ose humbje të të dhënave;
 - iv) në një mënyrë që i përdor Shërbimet ose softuerin përkatës për chat relay në internet, ndarjen e skedarëve nga kolegët, BitTorrent ose një rrjet server ndërmjetës;
 - v) në një mënyrë që përfshin dërgimin e spamit, dërgimin e emaileve të pakërkuara me shumicë ose të mesazheve komerciale apo mbajtjen e një releje të hapur SMTP ose
 - vi) në një mënyrë që shkakton dëmtim të rrjetit dhe
- f) të mos u publikoni palëve të treta asnjë rezultat të ndonjë testi standard ose të performancës të kartës SIM të integruar, të rrjetit, të Shërbimeve ose të komponentëve të tyre.

7.3. Do të duhet të përballoni çdo kosto të shkaktuar nga keqpërdorimi i Shërbimeve që rezulton nga shkelja e detyrimeve të lartpërmendura.

7.4. Nëse e shisni automjetin tuaj ose përndryshe ia ofroni një pale të tretë në mënyrë të përhershme, sigurohuni që ta çaktivizoni Bluelink-un në menynë e brendshme. Vini re se duke çaktivizuar Bluelink-un në menynë e bordit, të dhënat tuaja të automjetit nuk do të jenë më të dukshme në aplikacionin Bluelink dhe automjeti do të shkëputet nga aplikacioni Bluelink. Megjithatë, të dhënat e llogarisë suaj në aplikacionin Bluelink nuk do të fshihen.

8. **Disponueshmëria e rrjetit**

8.1. Ne i ofrojmë Shërbimet nëpërmjet një karte SIM të integruar në automjet. Prandaj, disponueshmëria e Shërbimeve tona:

- a) është e kufizuar territorialisht në rrezen e marrjes dhe të transmetimit të radiostacioneve të operuara nga operatori përkatës i rrjetit celular dhe mund të

ndikohet nga kushtet atmosferike, topografike, pozicioni i mjetit e pengesat, siç janë ndërtesat, dhe

b) varet nga funksionaliteti dhe gatishmëria operationale e rrjetit celular të kërkuar të kartës SIM të integruar.

- 8.2. Lidhja 4G/LTE (e ofruar nga një ofruer i jashtëm shërbimi) do të ofrohet vetëm në pajisjet e përputhshme (d.m.th. sistemi i info-argëtimit) që mbështesin frekuencën e veçantë 4G/LTE të rrjetit specifik të roaming.
- Aty ku nuk disponohet 4G/LTE-ja, do të ofrohet lidhja 2G ose 3G në varësi të disponueshmërisë së sistemit të info-argëtimit dhe pajtueshmërisë së tij me rrjete të tilla.

9. Disponueshmëria e Shërbimeve

- 9.1. Ne mund të çaktivizojmë përkohësisht ose përgjithmonë aksesin te Shërbimet tërësisht ose pjesërisht për arsye teknike ose sigurie ose për arsye të tjera të rëndësishme, të tilla si përmirësimi i performancës, përmirësimi i funksionalitetit, reflektimi i ndryshimeve në sistemin operativ ose trajtimi i çështjeve të sigurisë.

- 9.2. Shërbimet mund të ndërpriten ose kufizohen përkohësisht për shkak të forcës madhore ose për arsye të tjera jashtë kontrollit tonë. Kjo ndodh, për shembull, nëse lidhjet e të dhënave të ofruara nga operatorët e rrjetit celular nuk janë të disponueshme ose nëse lindin pengesa afatshkurtra të kapacitetit nga ngarkesat maksimale në Shërbime, në rrjetet me valë dhe fikse ose në internet.

- 9.3. Ne mund t'i ndërpresim apo t'i kufizojmë përkohësisht Shërbimet për të kryer ndërhyrje teknike ose të tjera (për shembull, riparime, mirëmbajtje, përditësime të softuerit dhe shtesa të tij) në sistemet tona ose në sistemet e ofruesve të ndryshëm, të ofruesve të përmbajtjes ose të operatorëve të rrjetit celular, atëherë kur këto masa janë të nevojshme për përmbushjen e duhur ose të përmirësuar të Shërbimeve.

10. Mbrojtja e të dhënave dhe siguria kibernetike

- 10.1. Për informacion mbi mënyrën se si i mbledhim dhe i përpunojmë të dhënat personale që lidhen me ofrimin e Shërbimeve, referojuni "Njoftimit tonë të privatësisë".

- 10.2. Ju lutemi informoni çdo drejtues tjetër të automjetit ose përdorues të mundshëm të Shërbimeve se Shërbimet janë të aktivizuara dhe se të dhënat (në veçanti të dhënat e vendndodhjes/GPS) do të mbliidhen dhe do të përpunohen siç përshkruhet në "Njoftimin e privatësisë".

- 10.3. Sa herë që kërkon të drejtat tuaja si subjekt i të dhënave ose bëni deklaratë sipas ligjit për mbrojtjen e të dhënave (p.sh. tërheqja e pëlqimit), kjo nuk do të ndikojë në vlefshmërinë e kontratës bazuar në këto Kushte.

- 10.4. Megjithatë, ne mund ta ndërpresim kontratën e bazuar në këto Kushte pa një periudhë njoftimi,

– nëse e tërhiqni pëlqimin tuaj (nëse është e aplikueshme) ose kundërshtoni përpunimin e mëtejshëm të të dhënave tuaja personale dhe

- nëse nuk jemi të detyruar në mënyrë të arsyeshme të vazhdojmë marrëdhënien kontraktuale deri në përfundimin e rënë dakord të kontratës ose deri në skadimin e një periudhe njoftimi ligjor ose kontraktual duke marrë parasysh fushën e përpunimit të të dhënave që vazhdon të jetë e lejueshme dhe duke peshuar interesat e të dyja palëve.

10.5. Për të garantuar menaxhimin e duhur të standardeve të përshtatshme të sigurisë kibernetike, automjetet tona, në varësi të modelit, mund të pajisen me veçori shtesë të sigurisë kibernetike.

Në një rast të tillë, pasi të keni aktivizuar Shërbimet në automjetin tuaj, niveli i sigurisë kibernetike të automjetit do të monitorohet vazhdimisht për të zbuluar dhe eliminuar shpejt kërcënimet e mundshme kibernetike.

Nëse nuk zbulohet ndonjë rrezik, të dhënat e ngjarjeve të sigurisë do të ruhen në automjetin tuaj.

Karakteristikat e sigurisë kibernetike mund të përditësohen herë pas here, kur është e nevojshme për të ruajtur standardet e sigurisë kibernetike.

Për më shumë informacion rreth mënyrës se si i mbledhim dhe i përpunojmë të dhënat personale për këto qëllime, referojuni "Njoftimit tonë të privatësisë".

11. **Afati**

11.1. Ju mund t'i përdorni Shërbimet sapo të keni përfunduar hapat e përshkruar në paragrafin 2.2 më sipër.

11.2. Kontrata jonë e bazuar në këto Kushte do të përfundojë automatikisht:

- a) kur ia ktheni automjetin tuaj shitësit në rast se marrëveshja e blerjes (ose e qirasë) për automjetin tuaj është anuluar ose revokuar;
- b) kur ju ose ne e çaktivizojmë llogarinë tuaj Hyundai në përputhje me kushtet e zbatueshme për llogarinë Hyundai ose
- c) në varësi të modelit të automjetit tuaj:
 - i) pas skadimit të 3 viteve (IONIQ 5, IONIQ 6, Kona e re (SX2)) ose
 - ii) pas skadimit të 5 viteve nga data e regjistrimit të automjetit (Të gjitha modelet e tjera përveç IONIQ 5, IONIQ 6 dhe Kona e re (SX2)).

Për detaje të mëtejshme, referojuni menysë së Hyundai Bluelink-ut.

11.3. Nëse kryeni ndonjë shkelje thelbësore të këtyre Kushteve, ne mund ta bllokojmë përkohësisht përdorimin e Shërbimeve nga ana juaj ose ta ndërpresim kontratën tonë duke e bllokuar përgjithmonë përdorimin e Shërbimeve nga ana juaj.

12. **E drejta për t'u tërhequr (vetëm për konsumatorët)**

12.1. Udhëzime rreth tërheqjes

E drejta për t'u tërhequr, siç përshkruhet më poshtë, do të zbatohet vetëm për konsumatorët, pra për çdo person fizik që hyn në një transaksion juridik për qëllime që janë kryesisht jashtë tregtisë, biznesit ose profesionit të tij.

E drejta për t'u tërhequr

Ju keni të drejtë të tërhiqeni nga kjo kontratë brenda 14 ditëve pa dhënë asnjë arsye.

Afati i tërheqjes do të skadojë 14 ditë nga dita e lidhjes së kontratës.

Për të ushtruar të drejtën tuaj për t'u tërhequr, duhet të na njoftoni (Hyundai Srbija d.o.o. Beograd, Milutina Milankovića 7V, 11070 Novi Beograd, Srbija, +381 011 2252

301, bluelink@hyundai-europe.com) me anë të një deklaratë të qartë në lidhje me vendimin tuaj për t'u tërhequr nga kjo kontratë.

Ju mund të përdorni formularin model të tërheqjes në paragrafin 11.3 më poshtë, por kjo nuk është e detyrueshme.

Për të ushtruar të drejtën tuaj për t'u tërhequr brenda periudhës së tërheqjes, mjafton që ta dërgoni njoftimin për ushtrimin e të drejtës për t'u tërhequr përpara skadimit të periudhës së tërheqjes.

Pasojat e tërheqjes

Nëse tërhiqeni nga kjo kontratë, aksesit juaj në Shërbime do të anulohet dhe të dhënat tuaja të përdorimit do të fshihen përgjithmonë.

- 12.2. E drejta për t'u tërhequr nuk ndikon në të drejtën tuaj për t'i çaktivizuar Shërbimet me ose pa shkak në çdo kohë në sistemin e info-argëtimit (te "Cilësimet" -> "Bluelink-u" -> "Çaktivizo Bluelink-un") ose në aplikacionin Bluelink (te "Më shumë " -> "Llogaria" -> "Mbyll llogarinë").

12.3. Formulari model për t'u tërhequr

(plotësojeni dhe kthejeni këtë formular vetëm nëse dëshironi të tërhiqeni nga kontrata.)

- Për Hyundai Srbija d.o.o. Beograd, Milutina Milankovića 7V, 11070 Novi Beograd, Srbija, +381 011 2252 301, bluelink@hyundai-europe.com
 - Unë/ne (*) njoftojmë se unë/ne (*) tërhiqemi nga kontrata ime/jonë (*) e shitjes së mallrave të mëposhtme (*)/për ofrimin e shërbimit të mëposhtëm (*),
 - Porositur më (*)/marrë më (*),
 - Emri i konsumatorit(ëve)
 - Adresa e konsumatorit(ëve)
 - Nënshkrimi i konsumatorit(ëve) (vetëm nëse ky formular dorëzohet në letër),
 - Data
- (*) Fshijeni sipas rastit.

13. **Ndryshimet**

Ne rezervojmë të drejtën për t'i ndryshuar këto Kushte ose Shërbime për shkak të zhvillimeve të ardhshme ekonomike, ligjore dhe teknike, në përputhje me dispozitat e mëposhtme.

- 13.1. Ndryshimet që janë ligjërish të dobishme ose neutrale për ju do të hyjnë në fuqi menjëherë.

- 13.2. Gjithashtu, ne mund të bëjmë ndryshime te Shërbimet, të cilat shkojnë përtej asaj që kërkohet për të ruajtur konformitetin me kontratën (p.sh. përditësimet, shihni paragrafin 5) nëse ka një arsye të vlefshme për një ndryshim të tillë, ndryshimi nuk përfshin kosto shtesë për ju dhe as nuk ndryshon thelbin e Shërbimeve dhe ju jeni i informuar në një gjuhë të qartë dhe të kuptueshme për ndryshimin.

Një arsye e vlefshme duhet të ekzistojë nëse ndryshimi është i nevojshëm që

- të përmirësojë aksesin dhe përdorshmërinë e Shërbimeve (duke përfshirë prezantimin e funksioneve ose funksionaliteteve ekzistuese ose të reja),
- t'i përshtatni Shërbimet me kërkesat e ndryshuara ligjore,
- t'i përshtatni Shërbimet me ndryshimet teknike ose zhvillimet në sistemet e operuara nga ne ose palët e treta ose me zhvillimet teknike në sistemet e

përdoruesve tanë;

- ndryshimet e nevojshme për arsye të rëndësishme operationale;
- ndryshimet që rezultojnë nga nevoja për të hequr paqartësitë, gabimet ose gabimet drejtshkimore që mund të ketë në Kushtet e përdorimit ose
- ndryshimet në të dhënat e kontaktit, emrat, numrat e identifikimit, adresat elektronike ose lidhjet e dhëna në Kushtet e përdorimit.

13.3.

Në rast të ndryshimeve të ilustruara në paragrafin 12.2, të cilat kanë ndikim të rëndësishëm negativ në aksesin tuaj ose në përdorshmërinë e Shërbimeve, ju do të informoheni në kohë me një gjuhë të qartë dhe të kuptueshme me anë të një mjeti të qëndrueshëm për veçoritë dhe kohën e ndryshimit dhe për të drejtën tuaj për ta përfunduar kontratën pa pagesë në çdo kohë; përveçse kur jua ofrojmë aksesin dhe përdorimin e Shërbimeve të pandryshuara pa kosto shtesë.

Gjithashtu, mund të ushtroni të drejtën tuaj të ndërprerjes duke çaktivizuar Shërbimet në sistemin e info-argëtimit (te "Cilësimet"->"Bluelink-u"->"Çaktivizo Bluelink-un") ose në aplikacionin Bluelink (te "Më shumë"->"Llogaria"->" Mbyll Llogarinë").

13.4.

Përndryshe, në rast ndryshimesh të tjera thelbësore në këto Kushte, ne do t'ju njoftojmë për ndryshimet e synuara me një njoftim të arsyeshëm paraprak. Nëse nuk na e tregoni ndryshe me shkrim (për shembull duke dërguar një letër ose email) brenda dy javësh pas njoftimit tonë, do të supozojmë se ju i pranoni ndryshimet (do t'jua kujtojmë këtë kur t'ju informojmë për ndryshimet e synuara). Nëse na thoni se nuk i pranoni ndryshimet, ne mund ta ndërpresim kontratën tonë bazuar në këto Kushte me efektshmëri nga data në të cilën ndryshimet duhej të ishin zbatuar.

14.

Të ndryshme

14.1.

Këto Kushte (si dhe çdo deklaratë e ofruar për mbrojtjen e të dhënave) formojnë kontratën midis jush dhe nesh në lidhje me Shërbimet dhe pasqyrojnë të gjithë marrëveshjen tonë në lidhje me Shërbimet (por vini re se, siç përmendet në paragrafin 2.2 më lart, për llogarinë Hyundai zbatohen kushte të veçanta përdorimi).

Çdo deklaratë ose njoftim që ju ose ne bëjmë sipas kontratës sonë - për shembull, për të ndryshuar kushtet e kontratës ose për ta ndërprerë kontratën - do të jetë efektive vetëm nëse bëhet me shkrim (për shembull duke dërguar një letër ose email) ose siç përcaktohet ndryshe shprehimisht në këto Kushte.

Deklaratat ose marrëveshjet me gojë nuk janë të mjaftueshme.

14.2.

Ne do të pranojmë kushte të tjera ose kushte shtesë vetëm nëse i kemi pranuar në mënyrë të qartë me shkrim.

14.3.

Ne mund t'ia transferojmë një pale të tretë të drejtat dhe detyrimet që kemi sipas kontratës sonë me ju, plotësisht ose pjesërisht.

Do t'ju njoftojmë për transferimin e synuar të paktën katër javë më përpara.

Nëse nuk jeni dakord me transferimin, mund ta zgjidhni kontratën me ne në çdo kohë (do t'jua kujtojmë këtë kur t'ju informojmë për transferimin e synuar).

14.4.

Nëse ndonjë kusht i kontratës sonë rezulton i pavlefshëm, ju dhe ne biem dakord që kushtet e tjera të kontratës sonë të mbeten të vlefshme dhe të paprekura.

14.5. Secili nga paragrafët e këtyre Kushteve funksionon veçmas. Nëse ndonjë gjykatë ose autoritet përkatës vendos që ndonjë prej tyre është i paligjshëm, paragrafët e mbetur do të mbeten në fuqi dhe me efektshmëri të plotë.

14.6. Edhe nëse e vonojmë zbatimin e kësaj kontrate, sërish mund ta zbatojmë më vonë. Nëse nuk insistojmë menjëherë që ju të ndërmerri ndonjë veprim që kërkohet sipas këtyre Kushteve ose nëse vonojmë në marrjen e hapave kundër jush në rast se ju e shkelni këtë kontratë, kjo nuk do të thotë që ju nuk duhet ta ndërmerri atë veprim dhe kjo nuk do të na pengojë të ndërmarrim hapa kundër jush në një datë të mëvonshme.

15. **Shërbimi ndaj klientit / Ankesat**

15.1. Nëse keni pyetje ose ankesa, mund të na kontaktoni në:
Hyundai Srbija d.o.o. Beograd, Milutina Milankovića 7V, 11070 Novi Beograd, Srbija, Telefon: +381 011 2252 301, Email: bluelink@hyundai-europe.com

15.2. Zgjidhja alternative e mosmarrëveshjeve është një proces ku një organ i pavarur shqyrton faktet e një mosmarrëveshjeje dhe kërkon ta zgjidhë atë, pa qenë nevoja t'i drejtoheni gjykatës. Komisioni Evropian ofron një platformë për zgjidhje alternative të mosmarrëveshjeve.
Ju mund të hyni në këtë platformë përmes lidhjes <http://ec.europa.eu/consumers/odr/>. Hyundai nuk është i detyruar dhe nuk merr pjesë në procedurat alternative të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve përpara një subjekti alternativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve për konsumatorët.

16. **Garancia**

16.1. Në rast se Shërbimet e ofruara janë me defekte, do të zbatohen detyrimet e garancisë në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

16.2. Përveç kësaj, në lidhje me Shërbimet do të zbatohen sa më poshtë:

- a) Nëse nuk e instaloni një përditësim ose nuk arrini ta instaloni siç duhet, ne nuk do të jemi përgjegjës për ndonjë defekt të Shërbimeve të shkaktuar nga mungesa e këtij përditësimi.
- b) Si rregull i përgjithshëm, nëse Shërbimet (duke përfshirë përditësimet e tyre) shfaqin defekte, do të supozohet se Shërbimet kanë qenë me defekt gjatë periudhës së mëparshme të ofrimit. Kjo nuk zbatohet nëse
 - i) në kohën përkatëse mjedisi juaj dixhital nuk ishte në përputhje me kërkesat teknike të Shërbimeve, siç u ishte komunikuar nga ne, ose
 - ii) ne nuk mund të hetojmë nëse kërkesat teknike janë përmbushur, ngaqë refuzoni për të bashkëpunuar për hetimin e rrethanave përkatëse në mënyrën e duhur dhe aty ku është e mundur për këto qëllime, dhe për të përcaktuar rrethanat përkatëse, kemi ndër mend të përdorim mjete teknike që përbëjnë sa më pak ndërhyrje për ju.

16.3. Kur paraqisni pretendimet tuaja në lidhje me defektet, do të bashkëpunoni me ne në masën e arsyeshme të nevojshme dhe të mundshme për të na mundësuar të hetojmë nëse shkaku i defektit ishte në mjedisin tuaj dixhital.

Detyrimi juaj për të bashkëpunuar është i kufizuar në mjetet teknikisht të disponueshme që përbëjnë sa më pak ndërhyrje për ju.

17. **Përgjegjësia**

- 17.1. Ne nuk do të jemi përgjegjës ndaj jush për saktësinë dhe përditësimin e të dhënave dhe për informacionet e transmetuara nëpërmjet Shërbimeve.
- 17.2. Ne nuk do të jemi përgjegjës ndaj jush për pasojat e keqfunksionimeve, ndërprerjeve dhe dëmtimeve funksionale të Shërbimeve.
- 17.3. Ne jemi përgjegjës ndaj jush për humbjet dhe dëmet e parashikueshme të shkaktuara nga ne.
Nëse nuk i respektojmë këto Kushte përdorimi, ne jemi përgjegjës për humbjen ose dëmin që pësoni, që janë rezultat i parashikueshëm i shkeljes nga ana jonë e këtyre kushteve ose i faktit që nuk kemi ushtruar kujdesin dhe aftësitë e arsyeshme, por ne nuk jemi përgjegjës për ndonjë humbje ose dëmtim që nuk është i parashikueshëm. Humbja ose dëmtimi është i parashikueshëm nëse është e qartë se do të ndodhë ose nëse, në kohën kur i pranuat këto Kushte përdorimi, ne dhe ju e dinim se mund të ndodhte.
- 17.4. Ne nuk e përjashtojmë apo kufizojmë në asnjë mënyrë përgjegjësinë tonë ndaj jush, kur do të ishte e paligjshme ta bënim këtë.
Kjo përfshin përgjegjësinë për vdekjen ose dëmtimin personal të shkaktuar nga neglizhenca jonë ose neglizhenca e punonjësve, agjentëve ose nënkontraktorëve tanë ose për mashtrim ose keqinterpretim mashtrues.
- 17.5. Kur jemi përgjegjës për dëmtimin e pronës suaj. Nëse përmbajtja dixhitale me defekt e furnizuar nga ne dëmton një pajisje ose përmbajtje dixhitale që ju përket juve, ne ose do ta riparojmë dëmin, ose do t'ju paguajmë dëmshpërblim.
Megjithatë, nuk do të jemi përgjegjës për dëmet që mund t'i kishit shmangur duke ndjekur këshillën tonë për të aplikuar një përditësim që ju ofrohej falas ose për dëmet e shkaktuara nga moszbatimi i saktë i udhëzimeve të instalimit ose moszbatimi i kërkesave minimale të sistemit të rekomanduara nga ne.
- 17.6. Ne nuk jemi përgjegjës për humbjet në biznes. Hyundai Bluelink-u është për përdorim privat. Nëse e përdorni Hyundai Bluelink-un për ndonjë qëllim tregtar, biznesi ose rishitjeje, ne nuk do të kemi asnjë përgjegjësi ndaj jush për ndonjë humbje fitimi, humbje biznesi, ndërprerje biznesi ose humbje të mundësive të biznesit.
- 17.7. Hyundai Bluelink-u dhe Shërbimet ofrohen për informacione të përgjithshme. Ato nuk ofrojnë këshilla në të cilat duhet të mbështeteni.
Ju duhet të merrni këshilla profesionale ose të specializuara përpara se të ndërmerri ose të mos ndërmerri ndonjë veprim në bazë të informacioneve të marra nga Hyundai Bluelink-u ose Shërbimet.
Edhe pse ne bëjmë përpjekje të arsyeshme për t'i përditësuar informacionet e ofruara nga Hyundai Bluelink-u dhe Shërbimet, nuk japim asnjë garantim ose garanci, qoftë të shprehur apo të nënkuptuar, që informacione të tilla janë të sakta, të plota ose të përditësuara.

17.8. Hyundai Bluelink-u dhe Shërbimet nuk janë zhvilluar për të përmbushur kërkesat tuaja individuale. Ju lutemi kontrolloni që pajisjet dhe funksionet e Hyundai Bluelink-ut dhe të Shërbimeve i plotësojnë kërkesat tuaja.